

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLUGOC			
GLLUGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	07/02/2019 20		
Nj. Org	Numër	Shtojca	Vlera
01	060	6976	

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: <u>07/02/2019</u>
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 1
<u>Takim i rregullt</u> / Redovni sastanak ____ Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak <u>X</u>
Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>16</u>
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku? Po / Da ☐ Jo / Ne ☐ Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice <u>X</u> ☐
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku? Po / Da <u>X</u> ☐ <i>KFOR-LMT K9 dhe OSCE.</i> Jo / Ne ☐ <i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë</i> <i>Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju</i>
A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik? Po / Da <u>X</u> ☐ Jo / Ne ☐
Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu: Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës: 1. Diskutim lidhur me rastin e fundit të dyshimit për abuzim seksual nga polici dhe profesori ndaj të miturës. 2. Të ndryshme. Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Fillimisht Kryetari Lladrovci hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, pastaj hedhi në votim rendin e ditës, me ç'rast edhe u aprovua.

Në këtë mbledhje të jashtëzakonshme është diskutuar rasti i fundit të dyshimit për abuzim seksual nga polici dhe profesori ndaj të miturës. Anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi kanë dënuar ashpër këtë rast dhe kanë kërkuar nga organet e rendit që sa më shpejt të zbardhet kjo çështje në mënyrë që të mos përsëriten rastet e tilla.

Në takim merrnin pjesë gjithë anëtarët e kësaj trupe për siguri, Kryetari i Komunës që është edhe kryesues i KKSB-së, Ramiz Lladrovci, Komandanti i Stacionit Policor në Drenas, Bashkim Bytyqi, përfaqësuesi i Bashkësisë Islame, Valon Bequku, përfaqësuesi i Komunitetit Katolik, kryetari nga Këshilli i Prindërve në Arsim, koordinatori i KKSB-së, përfaqësuesi nga FSK-ja, përfaqësuesi nga Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi, përfaqësuesja nga OJQ-të, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, përfaqësuesi nga komiteti i biznesit, përfaqësuesja nga mediat, përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, përfaqësuesi nga Këshilli i Veprimt Rinor Lokal, drejtori i DKA-së, përfaqësues nga KFOR-i dhe OSBE-ja.

Të pranishmit janë njoftuar nga kryetari Lladrovci me veprimet që ka marr Komuna lidhur me mësimdhënësin i cili është risuspenduar nga detyra dhe se ndaj të njëjtit do të zhvillohen edhe procedura dicipiniore sipas legjislacionit në fuqi.

Pas shumë diskutimeve në këtë mbledhje të jashtëzakonshme, janë dhënë dy rekomandime për të parandaluar dukuritë e tilla.

1. Të organizohet një fushat sensibilizuese nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Drenas, që të rinjtë ta kuptojnë se ku duhet t'i adresojnë ankesat e tyre të bazuara, si dhe
2. Janë sygjerruar media të kenë mirëkuptim në lidhje me raportimin e rasteve të tilla për arsye që t'u jepet mundësia institucioneve të rendit që të zbardhin rastet e tilla sa më shpejt.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:
Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Rinore Zymeri
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:
Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrovci

nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 07/02/2018

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.